



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.377/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj-kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj- anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Isuf Osmani, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.377/2025, datë 04.11.2025, e parashtruar nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Isuf Osmani, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga kandidati për anëtar në Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Isuf Osmani, pas publikimit të rezultateve përfundimtare të datës 03.11.2025, si kandidat për anëtar në Kuvendin e Komunës së Podujevës kishte marrur gjithsej 370 vota dhe pretendon se ka qenë personi i dytë ma i votuar pas bartësit të listës. Me tujte thekson se i është bërë e padrejtë pasi që janë zgjedhur dyandidate femra me me pak vota, pretendon se ka shkelje të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që ta marrin parasysh ankesën e tij dhe kërkon miratimin e saj në bazë të procedurave ligjore në fuqi.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur në ankesë, publikimin e rezultateve nga KQZ për anëtarët në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

Në përgjigjen në ankesë, KQZ-ja jep sqarimet/përgjigje sipas dispozitave ligjore, përkatësisht nenit 8, par.4, në ndërlidhje me par.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, përcaktohet qartazi që kuota gjinore prej 30% zbatohet brenda listave të subjekteve politike që kanë fituar mandate, me përjashtim të listave në kuadër të së cilave janë fituar dy mandate (ku ndarja behët në proporcion 50-50%) apo një mandat i vetëm (ku vendi i ndahet kandidatit apo kandidatës me të votuar). Të vepruarit ndryshe, sipas kërkesës së palës ankuese, do të cenonte parimin e barazisë para ligjit, në atë menyrë që po që se kuota për institucionin në terësi do të përmbushej vetëm nga një apo më shumë subjekte politike, të tjerat do të përjashtoheshin nga obligimi për të pasur të paktën 30% nga kandidatët e gjinisë së nënpërfaqësuar që fitojnë vende në kuvendet komunale. Poashtu, legjislacioni zgjedhor në zgjedhjet lokale nuk përcakton kuotën për kuvendin komunal si tërësi por për listat e subjekteve, si vijon:

Në kuptim të nenit 8 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

Një përcaktim i tillë është rikonfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, përmes Aktgjykimit në rastet KI45/20 dhe KI46/20 përcakton:

“131... Rrjedhimisht, parimet kushtetuese të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit mbeten të një rëndësie vendimtare dhe se çështja e kuotave gjinore, për arsye historike dhe kulturore, si dhe të mënjanimit të pabarazive faktike në mes grave dhe burrave, është në pajtueshmëri me frymën e sistemit normativ kushtetues.

“164...Gjykata potencoi se, ratio legis i LZP, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron-në çdo rrethanë-përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë. Mirëpo qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin 40 minimal të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënparfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të behën në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë që e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%.

Në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, lidhur me formulën për ndarjen e ulësve të Kuvendit të Komunës, si dhe numri më i vogël i kandidatëve nga gjinia e kundërt nëse numri i kandidatëve që kanë fituar mandate është dy (2) atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë një (1), pra duhet të jetë një mashkull dhe një femër. Gjithashtu edhe tek rastet kur subjekti politik ka fituar katër (4) ulëse, atëherë numri më i vogël nga të dy gjinitë duhet të jetë 2, pra duhet të jenë dy meshkuj dhe dy femra, sepse po që se do të jetë ndryshe

atëherë nuk do të arrihet përfaqësimi minimal në kuotën prej 30% i gjinisë së kundërt. KQZ ka bashkangjitur në përgjigje: Rezultatet për kuvendin komunal në Podujevë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore, përgjigjes në ankesë, konstaton se:

- **ankesa është e pabazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit gjeti se ankesa është e pabazuar sepse respektimi i kuotës nënkupton përfaqësim minimum 30% të gjinisë së kundërt dhe po që se përfaqësimi është 50% nga kjo rezulton se nuk është në kundërshtim me ligjin, duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, vendet që i ndahen subjektit politik sipas paragrafit 1 të këtij neni, u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur sipas par.2 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listën e rirenditur sipas një renditje rreptësisht zbritëse, deri në mbarimin e vendeve që i ndahen subjektit politik. Neni 8.4 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nëse pas ndarjes së vendeve, të përcaktuara në par.3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i përshtatshëm i gjinisë tjetër në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku 30%.

Nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.377/2025, datë 05.11.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.